

**TESTI PROFESIONAL  
PROCEDURË PENALE  
TEZA 22**

**I. Pyetje mbi koncepte (10 pikë)**

**Cili është kuptimi i provave që nuk rregullohen nga ligji dhe cilat janë kriteret e marrjes së tyre nga gjykata? Ilustrojeni përgjigjen me një shembull.**

Ligji procedural penal ka sanksionuar parimin e lirisë së provave, që ndërvepron me parimin e ligjshmërisë së marrjes së tyre. Kodi i Procedurës Penale lejon marrjen dhe vlerësimin edhe të provave që nuk parashikohen shprehimisht në ligj (provat jotipike) për të provuar faktet objekt prove. Ligjvënësi bën dallimin mes provës së marrë në shkëlqje të ndalimeve të parashikuara nga ligji, me provën që nuk rregullohet në ligj. Prova jotipike nuk është e paligjshme.

Kodi i Procedurës Penal lejon marrjen dhe vlerësimin e provave jotipike kur plotësohen njëkohësisht këto kriteret: (1) kjo provë vlen për të vërtetuar faktet objekt të të provuarit, ku gjykata duhet të verifikojë besueshmërinë e saj; (2) prova jotipike nuk cenon lirinë e vullnetit të personit (për shembull, nuk mund të merren e të vlerësohen prova apo pohime të marra nën torturë); (3) gjykatat në marrjen e këtyre provave respektojnë parimin e kontradiktoritetit, duke dëgjuar palët për mënyrën e marrjes së kësaj prove, në respekti edhe të parimit të barazisë së armëve.

Shembull të provave jotipike (që nuk rregullohen nga ligji) janë: regjistrimet private të bisedave nga njëri prej personave të përfshirë në komunikim (cilësuar si provë dokumentare e marrë në mënyrë jotipike); regjistrimet e kamerave të instaluar në subjekte private; njohja e personit me anë të fotografisë me qëllim për identifikimin e të dyshuarit/të pandehurit

**II. Pyetje krahasuese (10 pikë)**

**Bëni krahasimin e “kërkesës së viktimës akuzuese” (neni 59 i KPP) me “ankimin” (neni 284 i KPP)**

1. Viktima akuzuese është subjekt procedural dhe ka të drejtë të paraqesë kërkesë drejtpërdrejtë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë, për të vërtetuar akuzën dhe/apo për të kërkuar shpërbelimin e dëmit. Kërkesa për ndjekjen penale dhe deklarimin fajtor e dënimin e të akuzuarit është e domosdoshme për akuzën sipas nenit 59 të Kodit Procedurës Penale.

Ankimi i viktimës paraqitet tek prokuroria ose në policinë gjyqësore me anë të një deklaratë ku shfaqet vullneti për të proceduar në lidhje me një fakt që parashikon ligji si vepër penale. Në ankim viktimë paraqet faktin dhe burimet e provës, çdo element që identifikon të akuzuarin, si dhe shfaqjen e vullnetit për të proceduar penalisht të akuzuarin për veprat penale të parashikuara në nenin 284 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Kërkesa e viktimës akuzuese nënkupton ngritjen e akuzës dhe përfaqësimi i saj në gjykatë po nga viktimë akuzuese. Ngritja e akuzës nuk varet nga vendimmarrja e prokurorisë, pasi disponimin mbi akuzën penale e ka viktimë akuzuese dhe jo prokurori. Ky është rasti i vetëm ku ndjekja penale nuk ushtrohet nga prokurori që ka tagrin kushtetues, por nga individi.

*Albano Bekaj*

Ankimi i viktimës mbart dy cilësi atë të kallëzimit/njoftimit të veprës penale dhe atë të kushtit për të proceduar. Në këtë rast, ndjekja penale ushtrohet nga prokurori por viktima e kushtëzohet atë (ndjekjen penale) nëpërmjet paraqitjes së ankimit apo tërheqjes së tij.

3. Në rastin e akuzës së ngritur nga viktima akuzuese mungon faza e hetimit paraprak.

Në rastin e ankimit, depozitimi i tij në prokuroria sjell fillimin e procedimit penal dhe të hetimeve.

4. Në rastet e kërkesës së viktimës akuzuese, prokurori merr pjesë dhe jep mendim në lidhje me dënimin apo pafajësinë e të akuzuarit.

Në rastet e çështjeve të iniciuara mbi ankimin e viktimës, është prokurori që në përfundim të hetimit ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq.

5. Viktima akuzuese mund të tërheqë akuzën, në kushtet e parashikuara nga nenin 377 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin kur viktima akuzuese nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

Tërheqja e ankimit nga viktima, mund të bëhet në çdo fazë të procedimit, derisa vendimi i gjykatës nuk ka marrë formë të prerë. Sipas rastit dhe fazës ku është paraqitur kjo kërkesë, prokurori disponon për mosfillimin e procedimit penal ose pushimit të çështjes, si dhe gjykata disponon për pushimin e çështjes.

### III. Pyetje argumentuese (15 pikë)

Sipas nenit 434 të KPP, Gjykata e Lartë ka të drejtë që të vendosë për çështjet ligjore që duhet të shiheshin edhe kryesisht nga gjykatat e faktit, por që nuk janë parë prej tyre, edhe sikur ato të mos jenë ngritur në aktin e rekursit. Çfarë kuptoni me “çështje të ligjit që duhet të shihen, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit”? Ilustroni mendimin tuaj me një shembull konkret.

Juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë fokusohet në drejtim të ligjshmërisë së vendimeve të ankimuar, mënyrën e zbatimit të ligjit penal material ose procedural nga gjykatat e faktit. Gjykata e Lartë vendos mbi çështje të ligjit dhe jo mbi faktin, duke përfshirë edhe çështje të ligjit të cilat ndonëse nuk janë parashtruar në rekurs nga palët, shqyrtohen edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë procedimi (edhe në Gjykatë të Lartë).

Ligjvënësi nuk ka përcaktuar kuptimin e shprehjes “çështje të ligjit”, por si të tilla praktika gjyqësore ka pranuar çështje që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit penal material, siç është edhe cilësimi juridik i faktit penal. Çështje të ligjit që verifikohen kryesisht edhe nga Gjykata e Lartë janë edhe çështjet e zbatimit të gabuar të ligjit procedural penale, që sjellin si pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve apo papërdorshmërinë e provave të marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara në ligj.

Çështjet e ligjit analizohen dhe vlerësohen kryesisht nga Gjykata e Lartë dhe kanë si qëllim njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, garantimin e një procesi të drejtë, si dhe të drejtat kushtetuese e procedurale të të pandehurit. Në këtë vështrim, Gjykata e Lartë zbaton edhe parimin beneficium cohaesionis, që nënkupton shtrirjen e efekteve të ankimit/rekursit edhe mbi të bashkëgjykuarin që nuk ka bërë ankim. Në mënyrë që ky parim të gjejë zbatim, duhet të bashkekzistojnë dy kushte kumulative: së pari, shkaqet e parashtruara në rekurs në lidhje me zbatimin e ligjit penal nuk duhet të bazohen në motive personale; së dyti, vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të jetë në favor të të gjykuarit që nuk ka bërë rekurs, siç mund të jetë zbatimi i ligjit penal favorizues. Qëllimi i një parashikimi të tillë bazohet në parimin e drejtësisë dhe të barazisë së personave të akuzuar para ligjit, duke garantuar një trajtim të njëjtë për të gjithë ato që akuzohen për të njëjtin fakt penal dhe që ndodhen në të njëjtën situatë juridike e procedurale.

*Albano Zej*

Shembull: i pandehuri është dënuar për veprën penale të parashikuar nga nenin 143 i Kodit Penal, “Mashtrimi”, i kryer në bashkëpunim dhe me pasoja të rënda. Me ligjin nr. 36/2017 kjo dispozitë ka parashikuar ndryshime ligjore, ku në momentin e shqyrtimit të rekursit në Gjykatë të Lartë këto ndryshime kanë hyrë në fuqi. Kolegji Penal ka detyrimin të zbatojë ligjin penal favorizues, pavarësisht se në rekurs i gjykuari nuk ka ngritur pretendime në lidhje me cilësimin juridik të faktit të atribuar.

#### IV. Arsyetim analitik (15 pikë)

Me kërkesë të prokurorit, gjykata vendosi ndaj të hetuarit masën e sigurimit “arrest në burg”. Mbrojtja paraqiti apel. Gjatë gjykimit në apel, prokurori i apelit përkrahu kërkesën e mbrojtjes për ta zëvendësuar këtë masë me “arrest në shtëpi”, me argumentin se ishte cenuar rregulli i proporcionalitetit. Gjykata e apelit vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor.

Sipas mendimit tuaj, në këtë rast, cenohet rregulli që normon se gjykata nuk mund të vendosë një masë sigurimi më të ashpër se ajo e kërkuar nga prokurori? Arsyetoni mendimin tuaj.

Në gjykimin në apel, prokurori që ushtron funksionin pranë gjykatës së apelit, ka të drejtë të parashtrojë mendimin e tij në lidhje me çështjen, përfshi këtu edhe kërkimin e mbrojtjes për zëvendësimin e masës së sigurimit të caktuar ndaj të hetuarit. Por, mendimi i prokurorit në apel që përfaqëson çështjen në apel për shkak të ligjit apo qëndrimi i tij i ndryshëm në raport me prokurorin pranë gjykatës së shkallës së parë, nuk është i detyrueshëm për gjykatën e apelit që shqyrton çështjen. Çështja ndodhet në fazën e hetimeve prapake dhe prokurori i çështjes që ka ndjekur hetimet është ai që di dhe vlerëson nevojat e sigurimit, e në këtë rast konkret nuk ka ushtruar ankim.

Në kushtet kur ankues është vetëm i hetuari, vendimmarrja e gjykatës së apelit bazohet vetëm mbi shkaqet e parashtruara prej tij. Në këtë kuptim, mendimi/qëndrimi i ndryshëm i prokurorit në apel në raport me kërkimin e prokurorit pranë gjykatës së shkallës së parë (prokurori i çështjes), nuk është detyrues dhe as nuk kushtëzon vendimin e gjykatës së apelit. Mendimi i prokurorit të apelit nuk është mjet procedural që vë apo ka ënë në lëvizje gjykatën e apelit, e si rrjedhojë nuk cenohet rregulli i parashikuar nga neni 244 pika β e Kodit të Procedurës Penale, që sanksionon se gjykata nuk mund të vendosë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. Kjo pasi kërkesa për caktim mase është paraqitur nga prokurori që është i ngarkuar me hetimin e çështjes, pranë gjykatës së shkallës së parë, duke argumentuar kushtet dhe kriteret e caktimit të masës së sigurimit në rastin konkret.

Albana Betsi  
Alban Betsi